



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i kalendarit të posaçëm për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””, si dhe zhvillimit të seancave dëgjimore me grupet e interesit në funksion të transparencës parlamentare për miratimin e tyre si paketë ligjore.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Alban Zeneli, Ediola Braha dhe Nikolin Staka

Mungojnë:

Damian Gjiknuri dhe Tom Doshi

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjen e rendit të ditës, miratimi i kalendarit të posaçëm për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””, si dhe zhvillimit të seancave dëgjimore me grupet e interesit në funksion të transparencës parlamentare për miratimin e tyre si paketë ligjore.

Draftkalendarin që propozohet, të nderuar kolegë, e keni përpara. Para se ta votojmë, dua t’ju sjell në vëmendje dy gjëra. Komisioni ynë ishte caktuar si komision për dhënie mendimi për projektligjin, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, por në Konferencën e Kryetarëve, me kërkesën time, kam kërkuar të jemi komision për dhënie mendimi edhe për ligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, pasi janë pjesë e së njëjtës paketë, të asaj që quhet paketa antishpifje.

Është menduar të ketë një seri seancash dëgjimore me grupet e interesit. Është propozuar të kemi një kalendar të posaçëm. Në fakt, datat e zhvillimit të seancave dëgjimore duhet të ndryshojnë, sepse ky kalendar, që ne do të miratojmë sot, do të publikohet nesër në faqen zyrtare të Kuvendit dhe grupet e interesit, me të cilët do të zhvillojmë seancat dëgjimore, të kenë mundësinë të njihen edhe me dy projektligjet, por edhe të kenë një kohë të mjaftueshme në dispozicion, që unë propozoj të jetë gati një javë...

Klotilda Bushka – 10 ditë.

Ulsi Manja - 10 ditë është kohë e mjaftueshme nga momenti që ne do të miratojmë kalendarin sot.

E rëndësishme është që (kjo vlen për sekretarinë e komisionit, por edhe për këshilltarët e komisionit), duke qenë se ka ardhur buxheti dhe sipas kalendarit të posaçëm të miratuar në Konferencën e Kryetarëve dhe në seancën plenare, siç është bërë përherë, buxheti do të ketë kalendar të posaçëm, sepse zhvillohen disa seanca dëgjimore me rreth 13 institucione, që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve, tek të dy kalendarët të harmonizohen datat, që të mos kemi përplasje me ditët kur kemi seancat dëgjimore për buxhetin dhe për projektligjin e medieve audiovizive dhe të komunikimeve elektronike.

Klotilda Bushka – A mund të them dy fjalë?

Ulsi Manja – Po.

Zonja Bushka është relatore, së bashku me zonjën Hysi, tek të dy projektligjet.

Klotilda Bushka – Atëherë, kalendarin që keni në dispozicion fillon me ditën e nesërme, por do të fillojë në datën 15, të premten, për efekt të asaj që tha kryetari, që ne të rakordojmë datat edhe me kalendarin e posaçëm të shqyrtimit të projektligjit për buxhetin, si dhe për t'u lënë kohë gazetarëve, operatorëve mediatikë, shoqatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit, të kuptojnë përmbajtjen e ligjit dhe të vijnë me propozime konkrete, sepse synimi është të bëjmë dëgjesa cilësore. Ky është një ligj për grupet e interesit, është një ligj për publikun dhe ka sensibilitetin e vet. Ndaj, dëgjesat publike do të bëhen të ndara për grupe të veçanta interesi, sipas kalendarit që keni përpara.

Draftligji mbi të cilin do të bëhet prezantimi i nismës, si dhe dëgjesat publike, është i konsultuar me partnerët tanë, me OSBE-në, me ekspertët përkatës. Ky akt, së bashku me kalendarin, do të publikohet nesër në faqen zyrtare të internetit, si dhe do t'u njoftohet grupeve të interesuara, që t'u jepet mundësia të kuptojnë përmbajtjen dhe të bëjnë propozimet e tyre. Kjo është gjithçka.

Ulsi Manja – Pra, në kalendar propozohet të fillojmë në datën 15 apo ditën e hënë, në datën 18?

Klotilda Bushka – Në datën 15, që të jetë prezantimi i projektligjeve nga nismëtarët...

Ulsi Manja – Se deputetët ditën e premte mund të jenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk janë deputetët.

Klotilda Bushka – Po mirë, propozojeni, se nuk ka ndonjë rëndësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e bëjmë dot nesër, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozoj një ndryshim nga drafti.

Ulsi Manja – Të riskedulohen datat, sepse grupet e interesit kanë thënë se nuk mund ta miratojmë sot kalendarin dhe të fillojmë nesër me seancën dëgjimore, sepse i duan projektligjet në dorë.

Ditën e premte, siç propozon zonja Bushka të fillojë seanca dëgjimore, deputetët mund të jenë nëpër zona fundjavave.

Unë propozoj të fillojmë në datën 18.

Bashkim Fino – Prezantimi i projektligjit, bashkë me ata që duan të dëgjojnë dhe të marrin ndonjë kopje, mund të bëhet nesër.

Klotilda Bushka – Mund të bëhet në një seancë.

Bashkim Fino – Pse të bëhet kështu? Në mënyrë që ata të marrin nga një kopje, të dëgjojnë prezantimin dhe të...

(Diskutime pa mikrofon)

Klotilda Bushka - Është shumë shpejt nesër.

Ulsi Manja – Janë projektligje me shumë debate dhe...

Klotilda Bushka – E lëmë të hënën atëherë.

Ulsi Manja – Të hënën.

Klotilda Bushka – Pra, fillojmë në datën 18.

Ulsi Manja – Janë projektligje me shumë debate, Bashkim.

Adriatik Alimadhi – Ideja e zotit Fino ishte shumë e mirë. Prezantimi i projektligjit të bëhet nesër dhe pjesa tjetër, pika 2 dhe pika 3...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Kam një propozim, që ta zgjidhim dhe të mos na marrë shumë kohë.

Andi, të lutem, se një teknikalitet është!

Ne miratojmë sot kalendarin dhe e rëndësishme është që, si kalendar, ashtu edhe projektligjet, të njoftohen në faqen tonë zyrtare, si dhe t'u njoftohen grupeve të interesit. Koha në dispozicion vetëm mirë i bën procesit.

Unë them ta marrim në konsideratë propozimin e zotit Manja, që të hënën të bëhet prezantimi dhe të fillojnë edhe dëgjesat, si dhe të rakordojmë datat edhe me projektligjin për buxhetin, që të mos jemi të mbingarkuar me takimet.

Bashkim Fino – Do të kemi mbingarkesë...

Klotilda Bushka – Do të kemi, por të dyja janë të rëndësishme.

Bashkim Fino – Unë kam një sugjerim. I bie që këtë javë të na lësh kot, ndërkohë që prezantimin mund ta bëjmë. Nuk e di kush...

Ulsi Manja – Kemi projektligje të tjera ne.

Bashkim Fino – Nëse ka, dakord, por me programin që pashë mbi tavolinë, i bie që në datën 5 dhjetor është diskutimi në parim i buxhetit. Kjo do të thotë që para datës 5 dhjetor, nga 18-a deri në fund të nëntorit (mos harroni që ka edhe ditë pushim, 28-29 e të tjera me radhë), ne do të diskutojmë projektbuxhetin dhe kemi goxha ditë të ngarkuara me të, ndërkohë shtohet edhe kjo. Pra, prezantimi i kësaj duhet të bëhet nesër ose pasnesër. Ta gjejnë mundësinë nismëtarët ta bëjnë, që t'i dalim para kësaj.

Ulsi Manja – Ne nuk do ta votojmë në parim, thjesht do të prezantohet si paketë.

Bashkim Fino – Prezantim thashë, jo votim.

Ulsi Manja – Tani, unë them që për efekt të transparencës, më mirë është ta miratojmë sot dhe i publikojmë... Ju duhet të dini diçka: dy projektligjet akoma nuk janë në duart e deputetëve. Pra, të miratojmë kalendarin sot, të publikohen dy projektligjet sot dhe të dalin në faqen e Kuvendit, që, në radhë të parë, deputetët e Komisionit të Ligjeve të kenë kohë të njihen me projektligjet. Pastaj ditën e hënë të bëhet prezantimi në parim i dy projektligjeve.

Pastaj, mos u mërzisni, së këtë javë kemi punë sa të doni!

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, kush është dakord me projektkalendarin, me propozimin tim?

Bashkim Fino – Me cilin kalendar?

Ulsi Manja – Që të fillojmë të hënë me propozimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Duke filluar nga data 18 do të bëhet prezantimi i projektligjit. Pastaj do të hapim serinë e seancave dëgjimore.

Ndërkohë, draftkalendarin dhe dy projektligjet të publikohen sot në faqen e Kuvendit.

MBYLLET MBLEDHJA